

INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

PROGRAMI I LËNDËS

SË EDUKIMIT QYTETAR

KLASA I

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

TIRANË, 2003

1. HYRJJE

Edukimi qytetar synon të përgatisë nxënësit si qytetarë të ardhshëm aktivë. Një gjë e tillë do të mund të arrihet përmes zbulimit të dimensioneve qytetare, sociale dhe politike të jetës shoqërore.

Edukimi shoqëror, si pjesë e edukimit qytetar, është i rëndësishëm për çdo individ. Ai i aftëson nxënësit të përdorin mirë mendjen e tyre në një shoqëri komplekse dhe në ndryshim. Lënda e edukatës shoqërore i ndihmon nxënësit të kuptojnë mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve në shoqëri, si dhe natyrën dhe funksionimin e demokracisë. Nga ana tjetër, kjo lëndë përpiqet të edukojë një qytetar të pajisur me shprehjet dhe të kuptuarit e proceseve të cilat i aftësojnë ata të shohin, të gjykojnë, të vendosin dhe të veprojnë.

Metodologjitë e të mësuarit mbështeten në rolet aktive dhe bashkëpunuese, që i aftësojnë dhe fuqizojnë nxënësit të bëhen të rinj aktivë dhe pjesëmarrës.

2. QËLLIMET E PËRGJITHSHËM

Qëllimet dhe parimet e përgjithshme të edukatës shoqërore përputhen plotësisht me ato të kornizës kurrikulare të arsimit të detyruar. Në veçanti, qëllimet që ky program ka, lidhen me zhvillimin personal dhe social, ndihmesën në zhvillimin moral të nxënësve dhe përgatitjen për t'i bërë qytetarë të përgjegjshëm. Në këtë këndvështrim, lënda edukatë shoqërore synon:

- Të krijojë kushte që nxënësi të përfitojë njohuri të nevojshme për demokracinë dhe qytetarinë,
- Të mundësojë krijimin e qendrimeve dhe të vlerave, mësimin e strategjive efektive të zgjidhjes së problemeve, pranimit kritik të informacionit dhe mjeteve të komunikimit,
- Të japë ndihmesë në zhvillimin e vetëdijës së nxënësit se dukuritë janë të lidhura me njëra-tjetën në mënyrë të kushtëzuar dhe se janë në ndërveprim reciprok.

Qëllimet e veçanta

- T'i japë nxënësit njohuritë dhe t'i zhvillojë aftësitë intelektuale dhe qytetare, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të vepruar në jetën e përditshme qytetare;
- Nxënësi të kuptojë dhe të analizojë veprimin e tij dhe të shokëve, të grupeve dhe të institucioneve, si dhe ndikimin e tyre reciprok në jetën e individëve
- Të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësit dhe përfshirjen e tij të vetëdijshme dhe aktive në zgjidhjen e problemeve të komunitetit
- Të krijojë qytetarë të aftë, që të jenë të përgjegjshëm për veprime dhe marrëdhënie të pavarura me qytetarë e tjerë, me grupe dhe institucione të shoqërisë civile

3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

- Të njohë rëndësinë e qytetarisë demokratike, si dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në grup dhe institucione;
- Të kuptojë si ushtrohen rregullat në jetën e përditshme;
- Të njohë vlerat e shoqërisë ku jeton, si: barazinë, drejtësinë, solidaritetin etj.
- Të kuptojë rolin e të drejtave dhe të detyrave në qytetarinë demokratike.

Objektivat e veçantë

Kreu I. Kush jam unë

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të shprehë tiparet e tij kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët;
- Të dallojë tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai jeton;
- Të dallojë të përbashkëtat që gjenden ndërmjet tij dhe të tjerëve
- Të vendosë veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe ta shohë veten si pjesë e tij;
- Të respektojë vetveten dhe të shprehë me besim tiparet e tij;
- Të shprehë nevojat dhe dëshirat e tij;
- Të dallojë nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, të përbashkëtat dhe ato që ndryshojnë
- Të japë një shpjegim për këto ndryshime, për ndryshimet dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij dhe të tjerëve etj

Konceptet kryesore: *Unë, ti, familja, klasa, lagja, nevoja, dëshira, dallimi, e përbashkëtat, e ngjashmja etj.*

Kreu II. Unë dhe të tjerët (të drejtat dhe përgjegjësitë në grup)

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë lidhjet që ai ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë:
 - njerëzit e familjes,
 - shokët (në shkollë e jashtë saj),
 - mësuesit,
 - sendet me të cilat ka lidhje në jetën e përditshme,
 - mjedisi etj.
- Të dallojë dhe të vlerësojë nevojën që ai ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;
- Të dallojë dhe të vlerësojë atë çfarë ai mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon;
- Të vlerësojë mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të të tjerëve;
- Të shprehë përgjegjësinë e tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.

Konceptet kryesore: *Unë dhe tjetri, përgjegjësi, respekt, e drejtë, e gabuar, nevoja të përbashkëta, dëshira të përbashkëta.*

Kreu III. Të bashkëveprojmë

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri (në familje, klasë, grup, lagje etj.);
- Të vlerësojë dhe të respektojë rolin e tij dhe të tjerëve në familje, klasë, grup, lagje etj.;
- Të ketë besim tek vetja dhe tek të tjerët;
- Të bashkëveprojë me të tjerët në familje, klasë, grup, lagje etj., për të zgjidhur probleme të ndryshme;
- Të pranojë që ka njerëz që nuk kanë vështirësi për të kuptuar dhe për të bërë gjëra të ndryshme dhe të tregojë gatishmërinë për t'i ndihmuar ata etj.;
- Të flasë për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë

Konceptet kryesore: *rol shoqëror, punë e përbashkët, punë shtëpie, punë klase, punë në komunitet, respekt, vështirësi etj.*

Kreu IV. Rregullat

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë, shkollë, lojë etj.;
- Të pranojë rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar;
- Të demonstrojë gatishmërinë e tij për të ndjekur rregullat në veprimtaritë e përditshme në familje, grup, klasë, shkollë etj.;
- Të vendosë rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme;
- Të diskutojë për rëndësinë e bashkëpunimit me të tjerët për të vendosur rregulla sa më të drejta për të gjithë etj.

Konceptet kryesore: *rregull, veprimtari shoqërore, bashkëpunim etj.*

Kreu V. Siguria dhe mbrojtja

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të flasë për rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor;
- Të identifikojë disa nga rregullat e sjelljes së tij në:
 - Shtëpi,
 - Rrugë,
 - Park,
 - Lagje.
- Të listojë sjelljet e duhura në situta të ndryshme jetësore në mjediset që ai frekuenton:

Konceptet kryesore: *Rrezik, rrymë elektrike, qarkullim, vija të bardha, kryqëzim, trotuar, polic trafiku, semafor etj.*

4. STRUKTURA E PROGRAMIT

35 javë x 1 orë = 35 orë

Njohuri të reja: 26 orë

Veprimtari praktike: 5 orë

Përsëritje: 1 orë

Në dispozicion: 3 orë

Kreu I. Kush jam unë

1. Unë jam
2. Familja ime
3. Klasa ime
4. Lagja ku unë banoj
5. Nevojat dhe dëshirat e mia (pëmbledhëse)
6. *Veprimtari praktike shoqërore*
7. *Orë në dispozicion*

Kreu II. Unë dhe të tjerët (të drejtat dhe përgjegjësitë në grup)

8. Në familje
9. Në shkollë për të mësuar dhe për të respektuar
10. Të kemi respekt për gjërat
11. Të kemi respekt për mjedisin
12. Të kemi respekt për të tjerët (pëmbledhëse)
13. *Veprimtari praktike shoqërore*

Kreu III. Të bashkëveprojmë

14. Të mësojmë të punojmë së bashku
15. Të pranojmë atë që është në vështirësi
16. Unë në familje
17. Në shkollë
18. Në lagje
19. Këshillat e të tjerëve
20. *Veprimtari praktike shoqërore*
21. *Orë në dispozicion*

Kreu IV. Rregullat

22. Loja dhe rregullat (rregullat janë të domosdoshme)
23. Të mësojmë të luajmë së bashku (rregullat mund të vendosen bashkarisht)
24. Në familje
25. Në shkollë
26. Të mësojmë të rrimë së bashku, si të vendosim rregulla të mirë (pëmbledhëse)
27. *Veprimtari praktike shoqërore*

Kreu V. Siguria dhe mbrojtja

28. Jam vetëm në shtëpi
29. Në dyqan
30. Semafori
31. Në park
32. Lojërat në park
33. *Veprimtari praktike shoqërore*
34. *Orë në dispozicion*
35. *Përsëritje*

5. LIDHJE NDËRLËNDORE

Edukata qytetare, si pjesë e grupit të lëndëve shoqërore, përveç se është në veten e saj multidisiplinare, gërshetohet edhe me programet dhe përmbajtjet e lëndëve tjera shoqërore, si: histori dhe gjeografi, gjuhë dhe komunikim, por dhe me matematikën, fizikën, artet, edukimin fizik etj.

Gjuha dhe komunikimi. Esetë dhe shkrimet për temat e qytetarisë, si p.sh., “Kush jam unë?”, apo dhe përdorimi i gazetave, revistave, pjesëve letrare dhe shkrimeve të tjera që trajtojnë ngjarje dhe episode nga jeta e përditshme janë një urëlidhëse e natyrshme e trajtimit të temave të qytetarisë me fushën e gjuhës dhe të komunikimit. Gjuha amtare dhe e huaj shërbejnë mjaft për të dhënë tablonë e plotë të qytetarisë globale.

Artet. Përgatitja e materialeve ilustruese, si: postera, albume, si dhe efekte të tjera vizuale për një vetëdijësim qytetar demokratik në shërbim të pjesëmarrjes aktive dhe qytetarisë sa më të mirë është një mundësi e vazhdueshme e lëndës së edukatës qytetare me artet figurative. Kjo ndërthurje mund të përdoret në tema, si: nevojat dhe të drejtat e njeriut, rregullat e klasës, të shtëpisë dhe komunitetit etj. Edukimi artistik nëpërmjet këngëve, valleve popullore dhe të huaja, po ashtu rrit peshën e ndërveprimit të edukatës qytetare me muzikën, folklorin për tema globale, si: komuniteti lokal, rajonal, botëror, marrjen pjesë në veprime të thjeshta përmirësojnë jetën e shoqërisë, etj.

Matematikë. Përdorimi i numrave lidhur me tema aktuale të edukatës qytetare, interpretimi i të dhënave dhe dhënia e alternativave që lidhen me zgjidhjen e problemeve sociale brenda grupit, krijojnë po ashtu mundësi për qasje ndërlëndore.

Edukim fizik. Zhvillimi i veprimtarive të ndryshme sportive që lidhen me përkujtimin e datave të ngjarjeve dhe personave që kane dhënë ndihmesë në krijimin e vizionit të qytetarit në botë apo në vend, po ashtu janë një mundësi pozitive që favorizon lidhjen ndërlëndore.

6. UDHEZIME METODIKE

Për realizimin e programit mësimor në këtë lëndë, mund të organizohen takime me njerëz, mund të shfrytëzohen burime të ndryshme dhe të nxiten raste për zgjidhje:

- Takime me njerëz të ndryshëm të komunitetit (vëzhgime, intervista, anketime, bashkëbisedime, konsulta me ekspertë etj.);
- Përdorimi i publikimeve të ndryshme (gazeta, buletine informacioni, tekste, videokaseta, dramatizime, postera etj.);
- Simulime (lojërat me role, simulimi i debateve ose i situatave nga fusha të ndryshme të veprimtarive publike etj.).

Përveç metodave tradicionale, në lëndën e edukatës qytetare në shumë raste mund të zbatohet **loja me role**. Për zbatimin e kësaj forme të punës është e domosdoshme që të bëhet **simulimi** i një ngjarjeje. Nxënësit marrin role, p.sh., të mësuesit, të drejtorit të shkollës, të prindërve, të policit të qarkullimit rrugor, të anëtarëve të ndryshëm të komunitetit etj. Mësuesi në këtë rast luan rolin e bashkërenduesit, ndërsa të gjithë nxënësit e klasës marrin pjesë aktive në këtë proces. Ata mund të ndahen sërish në grupe, p.sh., grupi i punëtorëve që mbrojnë natyrën dhe parqet, grupi i fëmijëve që nuk rrespektojnë rregullat e caktuara për mjediset publike etj. Gjatë një ore mësimi mund të debatohet rreth asaj sesi është çështja, cilat janë rrugëzgjidhjet e problemit për të cilin debatohet etj.

Theks i veçantë në metodologjinë e punës do t'i kushtohet metodave aktive si:

- Puna me projekte,

- Mësimi problemzgjdhës,
- Mësimi me bashkëpunim,
- Biseda,
- Vëzhgimi,
- Puna në mjedise konkrete (me organizatat të ndryshme të komunitetit) etj.

Si forma të punës, mësimdhënësve u sugjerohet që të organizojnë punën në klasë me çifte dhe grupe. Ndarja e nxënësve në çifte dhe grupe, u jep atyre mundësi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Me këtë rast, nxënësve të ndarë në çifte dhe grupe u jepet 5 minuta kohë për të vendosur, p.sh., cili është roli i babait dhe nënës në familje. Kjo mund të arrihet përpara se të nisë diskutimi i gjithë klasës. Nxënësve duhet t'u tregohet koha për të cilën do të zgjidhet problemi. Ata ndahen në grupe apo çifte, ndërsa mësuesi luan rolin e mbikqyrësit dhe, sipas nevojës, jep edhe udhëzime apo sqarime. Në përfundim të orës së mësimi, çiftet apo grupet raportojnë para gjithë nxënësve të klasës. Secili grup duhet ta këtë përfaqësuesin, i cili raporton para klasës.

7. UDHEZIME PER VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e edukatës shoqërore duhet të jetë i përhershëm. Ky vlerësim ka qëllime të shumfishta. Kështu, përmes vlerësimit:

- sigurohen informacione për përparimin e nxënësit;
- nxënësit aftësohen të krahasojnë arritjet e tyre me përfundimet e pritshme. Në këtë mënyrë nxënësi do të bëjë edhe vetëvlerësimin e asaj që ka arritur të zotërojë;
- sigurohet motivimi i nxënësve për punë të mëtejshme;
- sigurohet edhe realizimi i objektivave.

Llojet e vlerësimit

Në të gjitha lëndët mësimore ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit. Në lëndën e edukatës shoqërore mund të zbatohen disa lloje të vlerësimit. Secili prej tyre ka qëllime të caktuara. Për klasën e parë të ciklit fillor është mirë që e gjithë veprimtaria e nxënësit të nxitet, nëpërmjet vënies në dukje e motivimit të veprimtarisë së tij. Mësuesi mund t'i përfshijë nxënësit në veprimtari të tilla:

- përmes përfshirjes në veprimtarinë e përditshme, dhënies së shembullit, pjesëmarrjes në konkurse, në biseda, në punë të klasës e të familjes;
- përmes tregimeve gojore që nxënësit mund të përshkruajnë veprimtarinë si dhe çfarë është mirë dhe çfarë është keq.

Vlerësimi duhet të jetë i përhershëm, duke filluar që nga orët e mësimi, veprimtaritë praktike e deri te vlerësimi përmes dukurive të ndryshme. Në klasë, gjatë orës së mësimi mund të bëhen këto vlerësime (gjithmonë si motivim e nxitje):

- vlerësimi i zakonshëm gjatë pjesëve të ndryshme të orës,
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë,
- vlerësimi i projekteve të realizuara individualisht ose në grup.

8. UDHEZIME PER ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi ka hapësira, me të cilat mësuesi mund të veprojë në shërbim të klasës që ka, rajonit ku ndodhet shkolla, veçorive fizike dhe njerëzore që ajo ka në

dispozicion. Orët e lëna në dispozicion përdoren nga mësuesi në përforcim të temave të veçanta mësimore, si orë përsëritjesh apo veprimtarish praktike.